



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**Raporti i Akreditimit Institucional të Kolegjit Universitar  
“Instituti Kanadez i Teknologjisë”**

**GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:**

1. Prof. Dr. Artur Ribaj                      Kryetar
2. Dr. Gjergj Thomai                      Anëtar

**Janar, 2023**

## Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi .....	Error! Bookmark not defined.
Përmbledhja e Raportit .....	Error! Bookmark not defined.
Përmbledhja e gjetjeve.....	8
Praktika e mirë.....	Error! Bookmark not defined.
Pikat e dobëta.....	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime .....	Error! Bookmark not defined.
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë .....	Error! Bookmark not defined.
Gjykime përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi .....	9
Fusha e vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi.....	10
Gjetje.....	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë.....	Error! Bookmark not defined.
Pikat e dobëta.....	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime.....	Error! Bookmark not defined.
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë .....	Error! Bookmark not defined.
Gjykimi .....	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet.....	14
Gjetje.....	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë.....	Error! Bookmark not defined.
Pikat e dobëta.....	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime.....	Error! Bookmark not defined.
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë .....	Error! Bookmark not defined.
Gjykimi .....	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 3: Programi i studimit.....	18
Gjetje.....	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë.....	Error! Bookmark not defined.
Pikat e dobëta.....	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime.....	Error! Bookmark not defined.
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë .....	Error! Bookmark not defined.
Gjykimi .....	Error! Bookmark not defined.
<b>Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, të Nxënit, Vlerësimi dhe Kërkimi .....</b>	<b>24</b>
Gjetje.....	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë.....	Error! Bookmark not defined.
Pikat e dobëta.....	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime.....	Error! Bookmark not defined.
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë .....	Error! Bookmark not defined.

Gjykimi .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre .....	30
Gjetje.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Praktika e mirë.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Pikat e dobëta.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Rekomandime.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Gjykimi .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Lista e evidencave .....	35

## **Rreth këtij vlerësimi**

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë mase Instituti Kanadez i Teknologjisë (IKT) përmbush Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, të cilat hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve ndërkombëtarë dhe shqiptarë të vlerësimit të arsimit të lartë të caktuar nga ASCAL-i. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert ndërkombëtar i vlerësimit të arsimit të lartë.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga institucionet e arsimit të lartë (IAL-të), por edhe për të informuar aktorët, qeverinë shqiptare, publikun dhe studentët se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënit të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi; Burime; Programe Studimi; Mësimdhënia, të Nxënit, Vlerësimi dhe Kërkimi; dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave më të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjyimit që ekspertët e vlerësimit mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët e vlerësimit do ta përbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Bordit të Akreditimit të ASCAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Për përgatitjen e këtij raporti, ASCAL-i ka ofruar mbështetje për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm duke u siguruar që ata t'i mbështesin gjetjet e bëra në raport me evidenca, si edhe duke redaktuar dhe duke përgatitur përmbledhjen e mëposhtme për raportin e plotë.

## Përmbledhja e Raportit

Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë (i njohur si IKT) u themelua si një institucion privat i arsimit të lartë në vitin 2011. Ai ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në fushën e Inxhinierisë Informatike dhe Ekonomisë. Në total, IKT-ja ofron 12 programe studimi, 6 programe "Bachelor" dhe 6 "Master Shkencor". Gjatë kohës së këtij vlerësimi, IKT-ja përbëhej nga Fakulteti i Inxhinierisë dhe Fakulteti i Ekonomisë. Secili prej tyre ka 2 departamente dhe njësinë përkatëse të kërkimit, të quajtura "Njësia e Kërkimit Shkencor në Inxhinieri" dhe "Njësia e Kërkimit Shkencor në Ekonomi". Universiteti ka disa laboratorë, një bibliotekë, salla mësimi të përmasave të ndryshme dhe disa zyra administrative për çështjet studentore.

Secili departament ka të paktën 7 anëtarë dhe të paktën 3 prej tyre kanë gradë apo titull shkencor. Për vitin akademik 2021-2022, IKT-ja ka 49 persona staf akademik. Sipas kualifikimit, stafi akademik u prezantua si në vijim: 5 profesorë (10.20%), 9 Prof. Asoc. Dr. (18.36%), 22 Dr.&PhD (44.89%), 13 MSc. (26.53%). Pra, 73% e tyre (36 staf akademik) kanë gradë shkencore dhe tituj akademikë dhe vetëm 27% (13 staf akademik) ka diplomë në Master Shkencor (**Aneksi 1, Tabela nr. 1-8**). Gjatë kohës së vlerësimit, institucioni kishte 790 studentë të regjistruar.

IKT-ja ka kaluar procesin për akreditimin e parë institucional nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në bashkëpunim me Agjencinë Britanike për Sigurimin e Cilësisë (ABSC), dhe është akredituar me Vendimin Nr. 116 të Bordit të Akreditimit, datë 15.12.2017, me një periudhë vlefshmërie prej 5 vjetësh, duke lënë tre rekomandime për institucionin, si më poshtë:

- Institucioni duhet të marrë masa në lidhje me përmbushjen e objektivave të qarta afatgjata të kërkimit, me produkte konkrete të koordinuara mes grupeve kërkimore, dhe në përputhje me fushat prioritare të kërkimit në nivel institucional. Ky rekomandim është përmbushur plotësisht nga institucioni [**D1, D9, D102**].
- Institucioni duhet të analizojë dhe të nxjerrë përfundime dhe të dhëna konkrete në lidhje me zbatimin e marrëveshjeve që mbështesin stazhet në institucione vendase dhe të huaja, si edhe punësimin sasior dhe cilësor të studentëve. Ky rekomandim është përmbushur plotësisht nga institucioni [**D4, D9, D89, D90**].
- Institucioni duhet të marrë parasysh ndryshimin në procesin e caktimit të programeve në fushën e inxhinierisë industriale dhe menaxhimit inxhinierik. Ky rekomandim është përmbushur plotësisht nga institucioni [**D159, D160, D161, D162, D163**].

Ky është Vlerësimi i dytë Institucional i IKT-së për të vlerësuar se në çfarë mase janë përmbushur Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, të cilat hynë në fuqi në vitin 2011. Raporti i vlerësimit të parë në korrik 2017 përfshinte dy karakteristika të praktikave më të mira; bënte një rekomandim që institucioni të trajtonte pikat e dobëta të identifikuar, dhe pohonte një veprim aktualisht në proces. Raporti përfshinte gjykimet e mëposhtme për secilën Fushë Vlerësimi:

- Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin janë **përmbushur plotësisht**.
- Standardet për Burimet janë **përmbushur plotësisht**.
- Standardet për Programin e Studimit janë **përmbushur plotësisht**.

- Standardet për Mësimdhënien, të Nxënit, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht**.
- Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**.

IKT-ja ka përgatitur raportin e vlerësimit të brendshëm, i cili është hartuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm. Grupi i vlerësimit të brendshëm përbëhej nga stafi i vjetër, staf akademik dhe administrativ, si edhe nga studentë. Draftet e RVB-së (Raport i Vlerësimit të Brendshëm) u qarkulluan për komente brenda institucionit, dhe në fund u finalizuan dhe u miratuan nga rektori dhe senati. RVB-ja bëri një prezantim të veprimtarisë së Kolegjit Universitar. Hartimi i RVB-së u mbështet nga evidenca, të cilat u ofruan përpara dhe gjatë procesit të vlerësimit. Evidencat u ofruan në anglisht dhe në shqip. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideroi RVB-në si një dokument të dobishëm, mbi të cilin të bazonte vlerësimin e tij.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi një vizitë dy ditore në institucion. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të vlerësimit të arsimit të lartë, njëri shqiptar dhe tjetri kanadezo-shqiptar. Ata u mbështetën nga Menaxheri i Vlerësimit të ofruar nga ASCAL-i, e cila është agjencia përgjegjëse për vlerësimin e arsimit të lartë në Shqipëri. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu dha raporti i vlerësimit të brendshëm dhe një dosje me evidenca mbështetëse disa javë përpara vizitës në institucion, si dhe iu siguroa dokumentacioni shtesë i kërkuar. Vlerësuesit shqyrtuan më shumë se 190 dokumente, të cilat u lejuan atyre të familjarizohen me strukturën, politikat, procedurat menaxheriale, ambientet, si dhe aktivitetet mësimore dhe kërkimore në institucion. Evidencat e shqyrtuara përfshinin Statutin e Kolegjit Universitar, Rregulloren Akademike, Raportet Vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, gamën e marrëveshjeve të jashtme, shembujt e informacionit mbi programet dhe evidenca nga takime konsultuese.

Gjatë vizitës dy ditore, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm organizoi disa takime, të cilat i lejuan ata të kuptojnë më mirë përgjegjësitë, procedurat dhe pikëpamjet e stafit dhe studentëve. Vlerësuesit u takuan me rektorin, stafin e vjetër, studentë, staf akademik, staf administrativ dhe mbështetës, ish studentë, dhe përfaqësues të organizatave vendase dhe partnere. Në të gjitha takimet u mbajtën shënime për diskutimet e kryera. Si pjesë e një turi në ambientet e institucionit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekat, sallat kompjuterike, laboratorët, hapësirat mësimore, hapësirat administrative dhe të gjitha ambientet e tjera të IKT-së. Pasi shqyrtoi të gjitha evidencat e disponueshme, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm doli në përfundimet si më poshtë.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij vendimi, grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë; nuk identifikoi asnjë pikë të dobët, por dha një rekomandim dhe identifikoi një veprim aktualisht në proces. Organizimi i IKT-së përcaktohet në Statutin e institucionit dhe në Librin e Rregulloreve, dhe për organizimin e mbledhjeve formale ndiqen procedura dhe protokolle të përcaktuara. Kolegji Universitar e ka projektuar kuadrin e tij qeverisës dhe rregullator në përputhje me kërkesat ligjore kombëtare të parashikuara nga ligji 80/2015 për institucionet e arsimit të lartë. Statuti, si dokumenti bazë që përcakton normat dhe rregullat bazë të funksionimit dhe aktivitetëve të IKT-së, është hartuar në përputhje me misionin, vizionin dhe objektivat e IKT-së.

Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht**. Në arritjen e këtij vendimi, grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë; ai identifikoi dy

pika të dobëta dhe bëri dy rekomandime për më shumë përmirësim të përdorimit efektiv të burimeve financiare dhe kapitale. IKT-ja ka vazhduar të përmirësojë efektivitetin e përdorimit të burimeve njerëzore. Grupi i vlerësimit të jashtëm konfirmoi se IKT-ja ka në përgjithësi sisteme dhe procese të përshtatshme për menaxhimin e stafit të tij akademik. IKT-ja ndjek politika të qarta dhe të hapura për burimet njerëzore, ku përfshihet rekrutimi dhe punësimi i stafit që plotëson kërkesat rregullatore. Politikat dhe procedurat mbështesin dhe udhëheqin në mënyrë efektive rekrutimin e stafit me kualifikimet e nevojshme, me kohë të plotë apo të pjesshme, për të plotësuar kërkesat akademike dhe administrative të institucionit. IKT-ja ka procedura të përshtatshme për vlerësimin efektiv të stafit akademik, bazuar në analizën e pyetësorëve me studentët dhe progresin e bërë drejt objektivave personale të dakordësuara në fillim të çdo sesioni akademik. IKT-ja ka një sistem menaxhimi arsimor me një gamë modulesh, që ofrojnë informacion për studentët dhe grupe të ndryshme të stafit.

Standardet për Programet Studimore janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij vendimi, grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë; ai nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk pohoi asnjë veprim aktualisht në proces, por bëri një rekomandim. Programet ofrohen në dy cikle studimi dhe pasqyrojnë misionin e Kolegjit Universitar dhe pozicionin e tij në vend dhe në tregun e punës. Programet studimore janë hartuar duke u bazuar tek kërkesat në tregun e punës dhe pasqyrojnë fleksibilitetin e këtij tregu. Programi Studimor ka objektiva të qarta studimi dhe trajnimi. IKT-ja ka krijuar lidhje të forta dhe gjithëpërfshirëse me institucione partnere dhe bashkëpunëtorë në aftësitë profesionale, të cilët mund të ndihmojnë studentët.

Standardet për Mësimdhënien, të Nxënit, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij vendimi, grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë; nuk identifikoi asnjë pikë të dobët dhe nuk pohoi asnjë veprim aktualisht në proces. Kolegji Universitar ka një agjendë kërkimore gjithnjë në përmirësim dhe mësimdhënia menaxhohet në mënyrën e duhur. Kolegji Universitar përmirëson në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e mësimdhënies, përfshi këtu angazhimin e ekspertëve të huaj. IKT-ja u ofron studentëve akses të konsiderueshëm për të kryer trajnime praktike dhe profesionale në bashkëpunim me disa institucione vendase, qofshin ato publike apo private. Më shumë staf akademik dhe studentë duhet të inkurajohen dhe të përfshihen në projektet kërkimore që ka IKT-ja.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij vendimi, grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë; ai nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk pohoi asnjë veprim aktualisht në proces. Statuti i IKT-së bën parashikimet e nevojshme për Këshillin Studentor, i njohur si “qeveria studentore”, dhe zëri i studentëve luan rolin kryesor në punën e institucionit. Studentët janë të përfaqësuar në Senatin Akademik dhe në të gjithë komitetet kryesore, si dhe në të gjitha nivelet vendimmarrëse.

IKT-ja e zhvilloi vlerësimin në përputhje me udhëzimet e ASCAL-it. Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi angazhimin e institucionit me këtë proces dhe bashkëpunimin me grupin e rishikimit të jashtëm gjatë gjithë vizitës. Në veçanti, grupi i vlerësimit të jashtëm komentoj mbi punën e grupit për vlerësimin e brendshëm të institucionit, i cili ofroi një bazë evidencash gjithëpërfshirëse, dhe Koordinatorin Institucional për vëmendjen e dhënë ndaj grupit të vlerësimit të jashtëm gjatë gjithë kohëzgjatjes së vizitës.

## **Përmbledhja e gjetjeve**

### **Praktika e mirë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e praktikave të mira si më poshtë:

- Biblioteka virtuale ka një fond të pasur librash, të pasuruar me tituj të shumtë, si pjesë e marrëveshjes me “McGraw-Hill Education”<sup>1</sup>, me Kompaninë “O’Reilly” përmes shpërndarësit TEXO, Shkollës së Biznesit në Harvard, si edhe përmes aplikimit falas të teknikave dhe metodave “e-learning” dhe “e-reading” për të gjithë studentët dhe stafin akademik. **(Kapitulli I Standardi I.4)**

### **Pikat e dobëta**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Institucionet e arsimit të lartë nuk kanë Drejtori të Auditimit të Brendshëm, dhe nuk ka analiza për planifikim financiar në planet financiare institucionale për periudhën 3-vjeçare në shqyrtim për ndërhyrje të posaçme apo diversifikim të fondeve për programet studimore për të garantuar vazhdimësinë dhe funksionimin normal të tyre. **(Kapitulli III Standardi VI.2 and VI.3)**
- Kreu i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) është staf administrativ dhe nuk caktohet në përputhje me nenin 28 të Statutit të IKT-së, ku përcaktohet se kreu i NJSBC-së duhet të jetë një ekspert i jashtëm me një mandat 4-vjeçar. **(Kapitulli III Standardi II.2)**

### **Rekomandime**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm bëri rekomandimet e mëposhtme:

- Rekomandohet që institucioni të ofrojë programe të përbashkëta me institucione të tjera të arsimit të lartë në Evropë apo Amerikën e Veriut, siç është përcaktuar në strategjitë e tij të zhvillimit gjatë dekadës së fundit. **(Kapitulli III Standardi III.2)**
- Rekomandohet që institucioni të krijojë një Drejtori për Auditimin e Brendshëm, dhe të analizojë raportet financiare dhe të krijojë plane financiare institucionale duke marrë në konsideratë rreziqet e brendshme dhe të jashtme, duke pasur plane rikuperimi të miratuara nga Bordi Administrativ për ndërhyrje të veçanta apo diversifikim të fondeve për programet studimore për të garantuar zhvillimin dhe funksionimin e tyre normal. **(Kapitulli III Standardi VI.2 dhe VI.3)**
- Rekomandohet që institucioni të caktojë kreun e NJSBC-së në përputhje me nenin 28 të Statutit të IKT-së. **(Kapitulli III Standardi II.2)**
- Rekomandohet që institucioni të bëjë përpjekje të mëtejshme për të formalizuar disa nga marrëveshjet me sipërmarrjet, duke marrë hapa konkrete. **(Kapitulli I Standardi I.1)**

### **Konfirmimi i veprimet të ndërmarrë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet aktualisht në proces si më poshtë:

- Zyra e ALUMNIT ka filluar të krijojë një bazë të dhënash për ALUMNIT për të kontrolluar se si programi i tyre studimor përshtatet me tregun e punës. Por, ka ende shumë punë për të bërë për të përfunduar një analizë cilësore në këtë fushë. **(Kapitulli III Standardi III.1)**

---

<sup>1</sup> <https://cit.edu.al/mcgraë-hill-literature/> (McGraw-Hill Education Textbook)



### **Përmbledhje e gjykimit për secilën fushë të vlerësimit**

1. Standardi për Organizimin dhe Menaxhimin është **përbushur Plotësisht**
2. Standardi për Burimet është **përbushur Kryesisht**
3. Standardi për Programet Studimore është **përbushur Plotësisht**
4. Standardi për Mësimdhënien, të Nxënit, Vlerësimin dhe Kërkimin është **përbushur Plotësisht**
5. Standardi për Studentët dhe Mbështetjen e tyre është **përbushur Plotësisht**

### **Gjykim i përmbledhur**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon Bordit të Akreditimit se në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përbushur Plotësisht.**

## **Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi**

- 1.1 IKT-ja, e themeluar në vitin 2011, e kryen aktivitetin e tij akademik dhe shkencor bazuar në legjislacionin në fuqi, në statutin e tij, dhe në të gjitha aktet e tjera të miratuar nga organet qeverisëse dhe autoritetet e IKT-së. Ai është një institucion privat që ofron programe studimore të arsimit të lartë të ciklit të parë dhe të dytë. Statuti i tij përcakton autoritetin, autonominë, qeverisjen, misionin dhe aktivitetet e IKT-së, dhe është miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (urdhër nr. 536, datë 24 nëntor 2016) **[RVB f. 13, D2, D3, D5, D13]**. Statuti është dokumenti themelor që përcakton normat dhe rregullat e funksionimit dhe aktiviteve të IKT-së, në përputhje me misionin, vizionin dhe objektivat e tij. Statuti është hartuar në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 33. Rregulloret e institucionit, së bashku me udhëzimet operationale të fakultetit dhe departamentit, interpretojnë Statutin për të dhënë udhëzime operationale për aktivitetet e institucionit dhe pjesën përbërëse të tij. Gjithashtu, misioni dhe plani strategjik i IKT-së janë hartuar në përputhje me Statutin, Ligjin për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore **[D1, D10, D12, D3, D8, Aneksi nr. 1]**. Këto dokumente rregullojnë aktivitetet mësimore, shkencore dhe administrative të universitetit në përputhje me misionin dhe objektivat e tij, dhe i kalojnë ndikimet rregullatore tek strukturat qeverisëse. **(Kapitulli III Standardi I.1)**
- 1.2 IKT-ja është organizuar në dy fakultete: Fakulteti i Inxhinierisë, me dy departamente dhe Njësinë e Kërkimit Shkencor në Inxhinieri “QIKZh Inxhinieria”; dhe Fakulteti i Ekonomisë, me dy departamente dhe Njësinë e Kërkimit Shkencor në Ekonomi “QIKZh Ekonomia” **[RVB f. 14, D2, D3, D8]**. Organizimi dhe menaxhimi i IKT-së sigurohen nga organe kolegjinale dhe kryhen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Organet më të larta vendimmarrëse janë Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, të cilët administrojnë aktivitetin akademik dhe financiar të kolegjit **[RVB f. 15, D2, D3, D8]**. Në IKT operojnë struktura të tjera kolegjinale, si dhe autoritete qeverisëse akademike dhe administrative në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Senati Akademik, si organi më i lartë kolegjal vendimmarrës, vendos për planifikimi strategjik më të rëndësishëm të institucionit në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, dhe jep miratimin e tij për çështje administrative dhe financiare. Ky organ funksionon sipas Statutit të IKT-së, i cili përcakton të gjitha kompetencat e tij. Ai mbledhet në mënyrë periodike, zakonisht një herë në muaj, dhe merr vendimet përkatëse. Bordi i Administrimit, si një organ kolegjal vendimmarrës mbikëqyr dhe kontrollon aktivitetin e universitetit në lidhje me menaxhimin administrativ, financiar dhe atë të aseteve të institucionit. IKT-ja ka një rektorat, i cili përbëhet nga rektori, zëvendës rektori dhe dekanët; një Senat Akademik, Këshilli i Etikës, Bordi i Administrimit dhe Këshillat e Fakulteteve, ku anëtarësia e secilit është përcaktuar në Rregullore. Departamenti është njësi bazë që mundëson dhe organizon diskutim konstruktiv mes anëtarëve të stafit akademik, dhe adreson marrëdhënien me studentët **[RVB f.15 & 16, D2, D3, D8]**. IKT-ja ka një Njësi të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), e cila ka për detyrë të garantojë cilësinë e brendshme bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator, në Statutin e IKT-së dhe në aktet nënligjore. **(Kapitulli III Standardi I.2)**
- 1.3 Organet kolegjinale të IKT-së takohet në mënyrë periodike në përputhje me parashikimet e rregulloreve specifike për funksionimin e tyre. Senati, si organi akademik kolegjal më i lartë në universitet, e kryen aktivitetin e tij përmes takimeve të rregullta **[M2 & M8, D3, D4, D7]**. Anëtarët e tij zgjidhen nga fakultetet, dhe përfaqësuesit e studentëve zgjidhen nga Këshilli/Qeveria Studentore. Senati Akademik i kryen funksionet e tij në bashkëpunim me organet e tjera kolegjinale të IKT-së. Ai bashkëpunon me Bordin e Administrimit dhe organe të tjera kolegjinale për të miratuar statutin dhe rregulloren e universitetit, planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë për zhvillimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor etj. Për më

tepër, Bordi i Administrimit, si organi kolegjal përgjegjës për administrimin financiar të institucionit, bashkëpunon me Senatin Akademik për të hartuar dhe miratuar buxhetin vjetor dhe buxhetin afatmesëm bazuar në propozimet e bëra nga njësitë kryesore dhe ato bazike për planin strategjik të zhvillimit institucional dhe për programin e buxhetit afatmesëm. Studentët përfaqësohen në të gjitha aktivitetet vendimmarrëse dhe kanë mundësi të kontribuojnë në debate [RVB f. 17; M2; M3; M4; M5; M6; M8; M10, D3, D4, D7, D8]. Studentë të ciklit të dytë cituan shembuj të ndryshimeve në programin studimor që kanë rezultuar nga kontributi i tyre [M4]. **(Kapitulli III Standardi I.3)**

1.4 IKT-ja funksionon në përputhje me kuadrin ligjor në fushën e arsimit të lartë, dhe bazuar në të ka hartuar statutet dhe aktet nënligjore që garantojnë autonominë e jashtme dhe të brendshme të institucionit. Autonomia e brendshme garantohet nga Statuti dhe Rregullorja e universitetit. Një nga mekanizmat e krijuar për të garantuar mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm është NjSBC-ja (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë), e cila është e detyruar të marrë përgjegjësinë e institucionit për monitorimin dhe vlerësimin e zhvillimeve institucionale [RVB f. 17, D3, D4, D7, D8]. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga përfaqësues nga secili fakultet, një student dhe një anëtar i jashtëm. Në fakt, anëtari i jashtëm është i punësuar me kohë të plotë në IKT, dhe mban gjithashtu rolin e kreut të NjSBC-së [M8, D3, D4, D7, D8]. Roli i NjSBC-së përfshin hartimin e vlerësimeve periodike të aktiviteteve të mësimore dhe atyre kërkimore, dhe, atje ku është e përshtatshme, angazhimin e konsulentëve/ekspertëve të jashtëm [RVB f. 18, D47]. **(Kapitulli III Standardi I.4)**

1.5 IKT-ja ka organizuar aktivitetin e saj bazuar në Strategjinë e Zhvillimit për 2017- 2024 [D.1], dhe gjatë 2020, bordet e tij miratuan Planin Strategjik të rishikuar për 2020-2025 [D10]. Plani Strategjik përmban objektivat, aktivitetet dhe qëllimet që duhet të arrijë IKT-ja [D.10]. Strategjia e Zhvillimit përcakton aspektet kryesore të institucionit që kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm, dhe përmban, mes të tjerash, një analizë SWOT dhe një analizë GAP [M10]. Në faqen 19 është krijuar një plan akademik bazuar në të dhënat e siguruara nga studime mbi zhvillimin e programeve, tendencave vendase dhe ndërkombëtare, si dhe mundësitë për të zhvilluar programe studimi, për të projektuar zhvillimin e këtyre programeve si në numrin e studentëve ashtu edhe në ofertën e re akademike për hapjen e programeve të reja [RVB f. 19; M2]. **(Kapitulli III Standardi I.5)**

1.6 Në fund të çdo viti akademik, në përputhje me Rregulloren dhe aktet nënligjore, IKT-ja përgatit dhe dorëzon Raportin Vjetor sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për aktivitetet e tij të brendshme dhe të jashtme [RVB f.19, D9]. Ky raport bazohet në evidenca nga departamentet, fakultetet, strukturat administrative dhe nivele të ndryshme të menaxhimit. Raporti Vjetor miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi Administrativ, dhe pastaj dorëzohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. IKT-ja publikon një përmbledhje të raportit në faqen zyrtare të internetit [<https://cit.edu.al/annual-report-2/>] [RVB f. 19, D9, D28]. **(Kapitulli III Standardi I.6)**

1.7 Struktura organizative e IKT-së është organizuar në njësitë kryesore (fakultetet) dhe njësitë bazike (departamentet / qendrat e kërkimit shkencor) në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 80/2015, si dhe duke ofruar liri akademike në përputhje me legjislacionin në fuqi. IKT-ja përbëhet nga dy fakultete, ku secili përbëhet nga dy departamente dhe një qendër kërkimore [RVB f. 20, D3, D4, Aneksi nr. 1, tabelle nr.1-8]. IKT-ja ka faqen e saj zyrtare në internet, e cila ofron informacion për stafin akademik, jetën studentore, kërkimin, pranimet dhe programet studimore që ofrohen nga universiteti [<https://cit.edu.al/>]. **(Kapitulli III Standardi II.1)**

- 1.8 Organet kolegjiale të IKT-së janë: Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Kuvendi i Stafit Akademik, Komitetet, Komisioni i Etikës, Qendrat, Rektorati dhe Zyra e Dekanit. Këto organe veprojnë në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë”, udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Statutin dhe aktet nënligjore. Institucioni ka komitete të përhershme për programet dhe kurrikulën; projektet kërkimore shkencore; aplikimet dhe inovacionin; dhe marrëdhënien me studentët dhe garantimin e të drejtave të studentëve **[RVB f. 21, D3, D27]**. Libri i Rregulloreve të Brendshme ofron detaje të mëtejshme mbi mënyrën e funksionimit të këtyre bordeve dhe komiteteve, dhe pasqyron një kulturë të diskutimit dhe vendimmarrjes së hapur dhe transparente **[RVB f. 22, D3, D8, D27]**. *(Kapitulli III Standardi II.3)*
- 1.9 IKT-ja përdor studimet e tregut për të identifikuar nevojat e tregut, mundësitë dhe qëllimet strategjike kombëtare. Studimi i fundit i tregut u krye në shtator 2021 mbi programet studimore që ofrohen nga dy njësitë kryesore. Studimi bëri një vlerësim të progresit të programeve studimore në përputhje me objektivat dhe Strategjinë e Zhvillimit të IKT-së. Pjesë e grupit vlerësues ishin gjithashtu studentët dhe ekspertë të jashtëm **[RVB f. 22, D4, D11, D12, D23, D30, D31]**. Ekziston Zyra e ALUMNIT [<https://cit.edu.al/student>], e cila ka filluar të krijojë një bazë të dhënash për ALUMNIT për të parë se si përshtatet programi i tyre studimor me tregun e punës. Por, ka ende shumë punë për të bërë për të përfunduar një analizë cilësore në këtë fushë. *(Kapitulli III Standardi III.1)*
- 1.10 IKT-ja i kushton një rëndësi të veçantë bashkëpunimit me partnerët. Gjatë zbatimit të strategjive të zhvillimit, institucioni është angazhuar në organizimin e tryezave të diskutimit me kompani të telekomunikacionit, banka dhe organe të tjera të jashtme **[M11; M2; M4, D1, D10, D66]**. Gjithashtu, IKT-ja ka bashkëpunim të mirë me institucione të tjera të arsimit të lartë jashtë vendit për sa i përket marrëdhënieve ndërkombëtare. Megjithatë, ai nuk ofron ende asnjë program të përbashkët me institucione të tjera të arsimit të lartë në Evropë apo Amerikën e Veriut, siç është përcaktuar në strategjitë e zhvillimit gjatë dekadës së fundit. IKT-ja vazhdon të ketë një politikë të dyerve të hapura në lidhje me bashkëpunimin rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, në përputhje kjo me misionin dhe qëllimin e tij, siç përshkruhet në strategjinë e institucionit **[RVB f. 16, D1, D10, D66]**. *(Kapitulli III Standardi III.2)*
- 1.11 IKT-ja bashkëpunon me institucione të ndryshme për partneritete dhe bashkëpunime kërkimore, si për shembull, institucione vendase, kompani, banka dhe organe të tjera të jashtme, të cilat ofrojnë stazhe, projekte dhe mënyra të tjera bashkëpunimi **[M3; M4; M11, D10, D29, D33]**. Për të mundësuar lëvizjen e studentëve, IKT-ja është pjesë e Programeve Erasmus+ dhe CEEPUS (Programi i Shkëmbimit të Evropës Qendrore për Studime Universitare). Gjithashtu, gjatë tre viteve të fundit, IKT-ja ka arritur 16 marrëveshje që mundësojnë lëvizjen e studentëve **[RVB f. 24, D29, D33, D34, D35, D36, D37]**. *(Kapitulli III Standardi III.3)*
- 1.12 IKT-ja ka treguar rezultate të mira në lidhje me lëvizshmërinë e studentëve dhe të stafit përmes bashkëpunimit në kuadër të marrëveshjeve të ndryshme ndërkombëtare. IKT-ja promovon dhe merr pjesë në aktivitete ndërkombëtare, si dhe ka organizuar disa konferenca ndërkombëtare në Tiranë **[RVB f. 25, Aneksi nr.2, Tabela nr 1-3]**. Stafi akademik dhe administrativ ka marrë pjesë në vizita për shkëmbime përvojash si pjesëmarrës në Programet Erasmus+ dhe CEEPUS **[RVB f. 24, Aneksi nr.2, Tabela nr 1-3]**. Disa nga studentët e diplomuar kanë vazhduar studimet master në vendet e Evropës Veriore **[M4]**. Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare është përgjegjëse për lëvizshmërinë e studentëve/stafit dhe mundësitë për shkëmbime eksperiencash në IKT. *(Kapitulli III Standardi III.4)*

## **Gjetje**

### **Praktika e mirë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

### **Pikat e dobëta**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

### **Rekomandime**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Rekomandohet që institucioni të ofrojë programe të përbashkëta me institucione të arsimit të lartë në Evropë dhe Amerikën e Veriut, siç është përcaktuar në strategjitë e zhvillimit të institucionit gjatë dekadës së fundit. **(Kapitulli III Standardi III.2)**

### **Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet aktualisht në proces si më poshtë:

- Zyra e ALUMNIT ka filluar të krijojë një bazë të dhënash për ALUMNIT në mënyrë që të shohë se si programet e tyre studimore përshtaten me tregun e punës. Por, ka ende shumë punë për të bërë për të përfunduar një analizë cilësore në këtë drejtim. **(Kapitulli III Standardi III.1)**

## **Gjykimi**

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin janë **përbushur plotësisht**.

## **Fusha e Vlerësimit 2: Burimet**

2.1 Statuti i IKT-së përcakton kriteret kryesore për rekrutimin, ndërkohë që pjesa tjetër përcaktohet në Librin e Rregulloreve. Rekrutimi i stafit mësimor, shkencor dhe administrativ bëhet në përputhje me kuadrin ligjor. IKT-ja vepron në përputhje me ligjet e punësimit dhe aktet nënligjore përkatëse, të cilat i prezantohen stafit akademik me kontratave të rregullta me kohë të plotë, stafit akademik me kontrata afatshkurtra dhe stafit administrativ. Për rekrutimin e stafit akademik në të gjitha nivelet e njësive akademike, institucioni ndjek procedura të unifikuara, të cilat shpallen publikisht në seksionin përkatës në faqen zyrtare të internetit të IKT-së. Gjithashtu, IKT-ja i publikon vendet vakante për stafin akademik dhe administrativ në faqen e tij zyrtare të internetit dhe në media të tjera. Për rekrutimin e stafit akademik, Departamenti i Burimeve Njerëzore ndjek rregullore të miratuara në nivel senati, të cilat përcaktojnë modalitetet e procedurave dhe kriteret e punësimit për stafin akademik **[D3, D8, D51, D52, D53, M6]**. IKT-ja ka për synim të zhvillojë kapacitetet mësimdhënëse përmes rekrutimit dhe ruajtjes së stafit akademik. Për vitin akademik 2021-2022, IKT-ja ka 49 staf akademik. Sipas kualifikimeve, stafi akademik është si më poshtë: 5 Profesorë (10.20%), 9 Prof.Asoc.Dr. (18.36%), 22 Dr. & PhD (44.89%), 13 MSc. (26.53%). Pra, 73% e tyre (36 staf akademik) kanë grada shkencore dhe tituj akademikë, dhe vetëm 27% (13 staf akademik) kanë një diplomë Masteri Shkencor **[Aneksi nr. 1, Tabela nr. 1-8]. (Kapitulli III Standardi IV.1)**

2.2 IKT-ja punon për të mbështetur zhvillimin e stafit të tij përmes zbatimit të politikave të stafit, organizimit të trajnimeve, takimeve dhe sesioneve informuese për punonjësit e rinj, dhe përmes aktiviteteve të tjera orientuese. Stafi mësimdhënës, veçanërisht pjesëtarë të stafit të ri, pohuan se ata janë të angazhuar në kurse trajnimi mbi mësimdhënien, të cilat ofrohen nga stafi më i vjetër dhe me më shumë përvojë **[M5, D8]**. Stafi administrativ dhe akademik i IKT-së ka marrë pjesë në disa Seminare Zhvillimi dhe Trajnime siç është përcaktuar në prioritetet e institucionit. IKT-ja gjithashtu mbështet trajnimin e stafit në institucione të tjera të arsimit të lartë në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete dhe projekte ndërkombëtare si Erasmus+ apo CEEPS, etj. Stafi akademik dhe administrativ përfshihet në dhënien e informacionit për aplikantët në Ditët e Hapura, duke përdorur fletëpalosje, prezantime dhe rrjetet sociale për të informuar aplikantët mbi programet studimore **[RVB f. 32, D54, D55]**. IKT-ja organizon aktivitete jashtëshkollore për stafin dhe studentët e tij, gjë që e lejon stafin të angazhohet në jetën sociale **[RVB f. 32; M5; M6]. (Kapitulli III Standardi IV.2)**

2.3 Bazuar në kuadrin rregullator, IKT-ja përcakton çdo vit objektiva për stafin në përputhje me rolin e tyre. Në fund të vitit akademik, IKT-ja kryen në mënyrë efektive vlerësimin periodik të stafit të tij përmes formularëve të vetëvlerësimit të dorëzuar nga secili individ, dhe përmes vlerësimit të marrë nga studentët, të cilët vlerësojnë si stafin ashtu edhe kursin. Vlerësimi i stafit bazohet në tre fusha kryesore; mësimdhënia, kërkimi shkencor dhe aktivitetet jashtëshkollore. IKT-ja përgatit raportin vjetor bazuar në raportet e përgatitura nga njësitë kryesore për performancën e secilit staf në lidhje me mësimdhënien, kërkimin dhe aktivitetet e tjera **[RVB f. 34; D56, D57, D58, D59, D60, D77, D78, Aneksi nr.2, Tabela nr. 4-5]. (Kapitulli III Standardi IV.3)**

2.4 Bazuar në "Strategjinë e Zhvillimit të IKT-së", stafi dhe studentët e IKT-së përfshihen gjithashtu në aktivitete sociale. Në këtë aspekt mund të përmenden shembujt të praktikave

të mira: Donacione nga Klubi i Bamirësisë, Aktivitete Sportive, Evente të Klubit të Studentëve, Konkursi i Personazhit Kulturor, dhe aktivitete të tjera sociale **[RVB f. 34; M3; M4, D1, D78, D79]**. Herë pas here organizohen seminare akademike nga profesorë të ftuar, të cilët japin leksione të hapura për komunitetin vendas **[D61, D62, D63, D64]**. **(Kapitulli III Standardi IV.4)**

- 2.5 Institucioni ka një njësi të burimeve njerëzore, e cila ndjek politika dhe linja raportimi të qarta, dhe ka për detyrë të mbështesë dhe mbikëqyrë burimet njerëzore. Kjo strukturë është pjesë e organit qeverisës të universitetit dhe funksionet e saj janë përcaktuar në dokumentet kryesore të universitetit, si Statuti dhe rregulloret e brendshme. Në përputhje me ligjin, ekziston një kontratë dhe një përshkrim pune për çdo pozicion në strukturën organizative të IKT-së **[M5; M6, D3, D8, D80]**. **(Kapitulli III Standardi II.2)**
- 2.6 Si një institucion privat, IKT-ja ka politikën e tij, por ai zbaton rregullat dhe rregulloret ekzistuese për menaxhimin financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve. Raundi i buxhetit vjetor fillon me kërkesat dhe propozimet nga departamentet dhe çdo nën njësi tjetër. Njësitë akademike nuk kanë autonomi financiare; buxheti është i centralizuar në nivel institucioni, dhe menaxhohet nga administratori, i cili mbikëqyrë nga bordi i drejtorëve. Shpërndarja e buxhetit miratohet nga Senati i Universitetit. Fakti që senati ka një anëtar përfaqësues të studentëve mundëson transparencën e informacionit për çështjet buxhetore tek studentët **[RVB f. 37; D3, D66, D67, D68]**. **(Kapitulli III Standardi VI.1)**
- 2.7 Buxheti fillestar hartohet duke u bazuar në propozimet e njësive, konsolidohet në nivel fakulteti, dhe pastaj i dërgohet Administratorit të Përgjithshëm, i cili formulon buxhetin e institucionit. Projekt buxheti i përgatitur nga Administratori i Përgjithshëm dhe zyra e kontabilitetit të IKT-së diskutohet dhe miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Pas miratimit të buxhetit të institucionit, një buxhet i decentralizuar i dërgohet kreut të çdo departamenti për zbatim. Niveli i zbatimit të buxhetit diskutohet në Senat dhe në Bordin e Administrimit. Raportet financiare përgatiten çdo vit në përputhje me kuadrin ligjor, dhe komunikohen në mënyrë të qartë si brenda ashtu edhe jashtë institucionit. Aktiviteti i IKT-së i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm bazuar në nenin 116 të Ligjit nr. 80/2015. Nuk ekziston një zyrë për auditimin e brendshëm, ndërkohë që siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 116 të Ligjit nr. 80/2015, institucioni i nënshtrohet rregullisht procedurave të auditimit të jashtëm **[RVB f. 37-38, D3, D9, D68, D69]**. **(Kapitulli III, Standardi VI.2; Kapitulli III, Standardi VI.3)**
- 2.8 IKT-ja ka një sistem që ofron menaxhim informacioni për grupe të ndryshme të stafit, burime të mësimdhënies dhe të nxënies, si dhe informacion për studentët. Kryesisht, informacioni i ndarë për studentët mbulon programet, kurset dhe leksionet **[M3, M4, M5, D40, D41, D70, D71]**. Ata gjithashtu mund të përdorin burime të tjera informacioni, si bibliotekat, laboratorët dhe arkivin elektronik. Faqja zyrtare e internetit është një burim i rëndësishëm informacioni **[<https://cit.edu.al/>]** për aktorët e IKT-së, ku ata mund të gjejnë detaje mbi programet studimore, kalendarin akademik vjetor, oraret mësimore, rregulloret, mënyrën e funksionimit, etj. IKT-ja është gjithashtu e pranishme në median sociale. Studentët pohojnë se mësuesit përdorin një sërë instrumentesh elektronike për t'i bërë burimet e disponueshme për studentët, përfshi këtu emaillet personale dhe paketat e programeve, si dhe një platformë “e-learning” **[M3, M4, M5, D72, D74, Turi]**. Klasat, laboratorët, sallat kompjuterike dhe bibliotekat janë të pajisura me teknologjinë e nevojshme të informacionit,

si për shembull, me linjë interneti, kompjutera, projektorë dhe programet e nevojshme **[Turi]**.  
**(Kapitulli III, Standardi VII.1; Kapitulli III VII.2)**

- 2.9 IKT-ja nuk zotëron asnjë pronë të paluajtshme; ajo ka marrë me qira një hapësirë të mjaftueshme në përputhje me numrin e studentëve të regjistruar në programet studimore të IKT-së. Ndërkohë, ai mban një regjistër të pronave të paluajtshme dhe asetëve të tjera, siç tregohet në Raportin e Aseteve Fikse dhe siç është certifikuar nga auditimi i jashtëm **[RVB f. 41, D3, D16, D17, D18, D19, D20, D21]**. **(Kapitulli III Standardi VII.3)**
- 2.10 Dokumentacioni është arkivuar sipas rregullave të institucionit, dhe në përputhje me Rregulloren e Arkivit. Për çdo student të regjistruar ekziston një dosje personale me të gjithë informacionin e nevojshëm. E njëjta gjë ndodh edhe në Zyrën e Burimeve Njerëzore, e cila ruan kopjen origjinale dhe formatin elektronik për të gjithë dokumentacionin e stafit akademik dhe administrativ. Baza elektronike e të dhënave ruhet dhe sigurohet në përputhje me elementet e sigurisë përmes sistemit “backup”. IKT-ja e ruan të gjithë informacionin e tij duke e publikuar dhe arkivuar atë, si dhe duke organizuar aktivitete të përbashkëta për shpërndarjen e informacionit. Ai e publikon informacionin institucional në faqen zyrtare të internetit **[RVB f. 41-42, D8, D76]**. **(Kapitulli III Standardi VII.4)**
- 2.11 Hapësira dhe infrastruktura e IKT-së është e përshtatshme për aktivitetin ditor administrativ dhe akademik **[M3, M4, M5, M6]**. Ndërtesa e re e marrë me qira përfshin zyra, hapësira sociale, salla mësimi, laboratorë, salla kompjuterike, biblioteka dhe ambiente argëtimi. Struktura logjistike e institucionit shërben për zhvillimin normal të punës, si dhe ofron shërbime për palë të treta në përputhje me nevojat e tregut **[M3, M4, M5, M6, D4, D21, D35, D39, Aneksi nr.1, Tabela nr. 1-9, Turi]**. **(Kapitulli III, Standardi VII.5, VII.6)**
- 2.12 Gjatë vizitës së grupit të vlerësimit të jashtëm në mjediset e IKT-së, në përgjithësi, fizibiliteti, klasat, zyrat dhe mjediset e tjera të ndërtesave plotësonin kërkesat e përcaktuara në Standardet publike përkatëse. U vu re që mirëmbajtja e tyre ishte e një cilësie të lartë **[Turi]**. Klasat kanë pajisjet kryesore të mësimdhënies, dhe i gjithë kampusi mbulohet nga rrjeti i internetit, i cili ofrohet në të gjitha klasat, laboratorët dhe në bibliotekë në mënyrë që studentët të mund të punojnë kudo që të duan. Masat e sigurisë ndaj zjarrit, pajisjet sanitare, pajisjet e higjienës dhe sistemi i ngrohjes i plotësonin Standardet e kërkuara. **[Turi, D16, D17, D18, D19, D20, D21, D74]**. **(Kapitulli III Standardi V.1)**
- 2.13 Bazuar në rregullat e brendshme (Libri i Rregulloreve), zyrat përkatëse të IKT-së ruajnë kopje të printuara dhe elektronike të të dhënave; për shembull, regjistrimi i studentëve dhe të dhënat e matricimit ruhen në sekretariatet e fakulteteve, nga Regjistruesi dhe Zyra e Pranimeve; materialet e mësimdhënies, pasi miratohen nga Senati Akademik, ruhen në arkiv dhe në Zyrën e Protokollit. Të gjitha këto dokumente janë në dispozicion të studentëve përmes bibliotekës apo sistemit SMU (Sistemi i Menaxhimit të Universitetit). Sekretaria mësimore e secilit fakultet ruan një kopje të printuar dhe një kopje elektronike të të dhënave të regjistrave që përmbajnë të dhëna personale të studentëve, së bashku me informacione të tjera për studentët, ku përfshihen rezultatet e vlerësimeve, programet e studimit, diplomat dhe suplementi. Kopjet e printuara të të gjitha dokumenteve të aktiviteteve kryesore akademike duhet të arkivohen sipas Rregullores së Arkivit **[RVB f. 46-47, D8, D9]**. **(Kapitulli III Standardi V.2)**



## **Gjetje**

### **Praktika e mirë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

### **Pikat e dobëta**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi pikat e dobëta si më poshtë:

- IKT-ja nuk ka një Drejtori të Auditimit të Brendshëm, dhe nuk ka një analizë për planifikim financiar në planet financiare të institucionit për periudhën 3-vjeçare në shqyrtim, për ndërhyrje të posaçme apo diversifikim të fondeve për programe studimore, në mënyrë që të garantohet zhvillimi dhe funksionimi normal i tyre. **(Kapitulli III Standardi VI.2 and VI.3)**
- Kreu i NjSBC-së është staf administrative dhe nuk caktohet në përputhje me Nenin 28 të Statutit të IKT-së, ku përcaktohet se kreu i NjSBC-së duhet të jetë një ekspert i jashtëm për një periudhë 4-vjeçare. **(Kapitulli III Standardi II.2)**

### **Rekomandime**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Rekomandohet që institucioni të krijojë Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, të analizojë raportet financiare dhe të krijojë plane financiare institucionale që marrin në konsideratë rreziqet e brendshme dhe të jashtme duke pasur plane rikuperimi të miratuara nga Bordi i Administrimit për ndërhyrje të posaçme apo diversifikim të fondeve për programet studimore, në mënyrë që të garantohet zhvillimi dhe funksionimi normal i tyre. **(Kapitulli III Standardi VI.2 dhe VI.3)**
- Rekomandohet që institucioni të caktojë kreun e NjSBC-së në përputhje me nenin 28 të Statutit të IKT-së. **(Kapitulli III Standardi II.2)**

### **Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

### **Gjykimi**

Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht.**

### **Fusha e Vlerësimit 3: Programi i Studimit**

- 3.1 Institucioni punon për të krijuar mundësinë që publiku të njohë institucionin dhe programet e tij studimore përmes mbulimit mediatik, reklamave, publikimit të broshurave, fletëpalosjeve, prospekteve, faqes së internetit dhe rrjeteve sociale. Programet publikohen në faqen zyrtare të internetit **[RVB f. 51-52; D81, D54, D55]**. Institucioni ofron programe studimi në përputhje të plotë me infrastrukturën, kapacitetet dhe fushat prioritare të specifikuara në Statut, si dhe mbështet ofrimin e programeve me staf shqiptar dhe të huaj që kanë kualifikimet përkatëse. Programet studimore harmonizojnë të gjithë komponentët e tyre bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë (Ligji 80/2015), si dhe në aktet nënligjore në fuqi. Programet që ofrohen përputhen me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve studimore që ofrohen nga institucionet e arsimit të lartë" (i ndryshuar) **[D63, D62, D3, D83, D82]**. Institucioni është i angazhuar të ruajë marrëdhënie të mira me disa institucione të tjera, si universitete, kompani, biznese, banka, etj. Në total, institucioni ka 104 marrëveshje të firmosura me universitete brenda dhe jashtë vendit, me sipërmarrje, biznese, partnerë të ndryshëm, etj. Megjithatë, rekomandohet që institucioni të formalizojë disa nga këto marrëveshje duke marrë masa konkrete **[D61, D62, D63, D64]** **[Aneksi nr. 1, Tabela nr.9]. (Kapitulli I Standardi I.1)**
- 3.2 Nga dokumentacioni i ofruar dhe nga takimet me stafin drejtues, u vu re se IKT-ja ka krijuar një qendër që menaxhon trajnime, programe të edukimit të vazhdueshëm dhe zhvillimin e stafit dhe studentëve. Përmes Qendrës së Trajnimeve dhe Edukimit të Vazhdueshëm, institucioni ka ofruar kurse dhe trajnime të ndryshme ndër vite. Gjatë takimeve, u theksua se njësitë kryesore po kërkojnë mundësi për të zgjeruar gamën e programeve të edukimit të vazhdueshëm dhe organizimin e trajnimeve dhe kurseve të ndryshme profesionale të certifikuara. IKT-ja është pjesë e Akademisë CISCO dhe u ofron studentëve kurse profesionale sipas licencave të ofruara nga kjo akademi ndërkombëtare **[D4, D22, D38]**. Forma e studimit në IKT është me kohë të plotë. Programet studimore, kurset dhe trajnimet ofrohen në gjuhën angleze, gjë që u shërben studentëve për të qenë në kontakt me tendencat, njohuritë dhe literaturën më të fundit, si dhe me nevojat e tregut të punës. Institucioni e organizon procesin arsimor në mënyrë të tillë që programet e ciklit të dytë të studimit të kryejnë studimet pa u shkëputur nga puna **[D84, D85]**. Për të vlerësuar përvojën e fituar në ofrimin e programeve të edukimit të vazhdueshëm, institucioni ka krijuar Qendrën e Trajnimit dhe Edukimit të Vazhdueshëm. Ndërkohë, për të ruajtur cilësinë dhe për të vlerësuar përvojën institucionale është krijuar Njësia për Sigurimin e Cilësisë. Programet studimore vlerësohen në mënyrë periodike (dy herë në vit, përpara fundit të semestrit) dhe procesi bazohet në Manualin për Sigurimin e Cilësisë (Manuali SC) **[D86, D87, D88, D89, D90, D91, D142]. (Kapitulli I Standardi I.2)**
- 3.3 IKT-ja ofron programe studimi në përputhje me "Studimin e Tregut" (Studim fizibiliteti) dhe bazuar në "Planin Strategjik dhe Planin e Biznesit të Institucionit", të miratuar me Vendim të Senatit Akademik. Programet studimore janë në përputhje me "Strategjinë e Zhvillimit të IKT-së për 2017-2024". Programet studimore të IKT-së përputhen me vizionin, misionin dhe objektivat e institucionit për të ofruar programe studimore të ciklit të parë dhe të dytë në fushën e inxhinierisë dhe ekonomisë. Programet studimore të ciklit të dytë janë projektuar si një vazhdim i thelluar logjik i njohurive të fituara gjatë ciklit të parë studimor, por me një profil më të thellë shkencor. Njësitë kryesore, përmes Komitetit të Programeve Studimore, kryejnë vlerësime periodike të programeve studimore, si dhe vlerësojnë përputhshmërinë e tyre me objektivat, strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe fakultetit, dhe me studimin e tregut të punës **[D11, D12, D1, D3, D50, D92]**. Për vlerësimin e programeve të studimit, njësitë angazhojnë ekspertë me përvojë në mësimdhënie dhe në hartimin e programeve studimore.

Disa programe studimore janë përditësuar në masën 20% të kurrikulës, me miratim paraprak nga Ministria e Edukimit dhe Sportit. Institucioni i bazon procedurat e vlerësimit të programeve të studimit dhe përditësimin e tyre në manuale dhe praktika të konsoliduara **[D93, D142, D1, D94]. (Kapitulli I Standardi I.3)**

3.4 IKT-ja ka një strukturë institucionale që ndahet në dy fusha: ekonomi dhe inxhinieri. Ky profil është ndjekur vazhdimisht për hapjen e programeve të reja të studimit. Për zhvillimin e tij, institucioni bazohet tek qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në Statut dhe në Strategjinë e Zhvillimit **[RVB f. 55; D3, M2, M10]**. Programet studimore që ofrohen janë orientuar drejt tregut të punës vendas dhe atij të huaj. Për të arritur këtë qëllim, institucioni ka punësuar staf me përvojë ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, dhe me vite përvojë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Organizimi i mësimin në gjuhën angleze, literatura e përdorur në mësimdhënie në bashkëpunim me “McGrawHill Education”, si dhe stafi i diplomuar në universitetet ndërkombëtare janë një garanci për studime cilësore, të cilat i përgatisin studentët për një karrierë akademike apo për tregun e punës **[D42, D3, M3, M4, M5]**. Institucioni vë në dispozicion të studentëve një bibliotekë shumë të pasur me libra në fushën e inxhinierisë dhe ekonomisë falë marrëveshjes që ka me dy kompani ndërkombëtare si “McGrawHill Education” dhe “O’Reilly”. Çdo student që ndjek një nga programet studimore të IKT-së mund të përdorë falas bibliotekën virtuale të “McGrawHill Education” dhe “O’Reilly” **[D41, Turi]**. Fakulteti i Ekonomisë ka firmosur një marrëveshje në vitet 2020-2021 me Kolegjin Gjeorgjian në Ontario, Kanada, për njohjen e krediteve të fituara nga studentët e ciklit “Bachelor” në programin Administrim Biznesi **[D95]. (Kapitulli I Standardi I.4)**

3.5 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm evidentoi se institucioni e shpërndan ngarkesën mësimore për programet e studimit në përputhje me kuadrin ligjor. Ngarkesa mësimore shpërndahet në përputhje me nevojat e njësive bazike, bazuar në kuadrin ligjor, duke marrë parasysh llojin e angazhimit të stafit akademik në institucion, dhe kualifikimet dhe përvojën në mësimdhënie. Institucioni e miraton ngarkesën mësimore me vendim të Senatit Akademik në fillim të çdo viti akademik. Ngarkesa ndryshon për kategoritë e personelit akademik sipas funksionit, nivelit dhe titujve akademikë **[RVB f. 57; D27]**. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për stafin që ndjek ciklin e tretë të studimeve, duke reduktuar ngarkesën mësimore, si dhe duke u dhënë atyre kohë të lirë për të punuar mbi artikuj dhe për të marrë pjesë në konferenca shkencore. Institucioni i ka përcaktuar qartë kriteret dhe kategoritë e stafit akademik që përfiton nga zvogëlimi i ngarkesës mësimore **[D77, D78, M5]. (Kapitulli I Standardi I.5)**

3.6 IKT-ja u ofron studentëve informacion për programet e studimit, lëndët e programeve, si dhe informacione të tjera që duhet të dinë mbi programet ku janë regjistruar apo ku kanë aplikuar. Programet e studimit publikohen gjithashtu në faqen zyrtare në internet të institucionit. Në fillim të çdo semestri, lektorët u prezantojnë studentëve programet mësimore, ku shpjegojnë në detaje temat dhe literaturën e lëndës, mënyrën e vlerësimit dhe literaturën e rekomanduar. Përmes “Udhërrëfyesit të Studentit”, studentët marrin informacion mbi institucionin dhe programin që do të ndjekin. Shpjegime të tjera mbi follow-up-et e programit, lëndët, detyrimet akademike dhe administrative, vlerësimin, praktikën dhe diplomimin, jepen gjatë Javës së Orientimit **[RVB f. 57-58; D54, D55, D97]**. Objektivat e programeve studimore përcaktohen dhe publikohen si në faqen e internetit të institucionit, ku programet publikohen sipas fakultetit dhe departamentit, ashtu edhe në Rregulloren e Programeve Studimore **[D84]**. Çdo vit, institucioni miraton me Vendim të Senatit Akademik kuotat dhe kriteret për regjistrimin e studentëve, të cilat i dërgohen Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për çdo vit pasues. Gjithashtu, institucioni i publikon kriteret në faqen zyrtare të internetit. Informacion i

detajuar ofrohet edhe për dokumentacionin e regjistrimit dhe për bursat që institucioni ofron në kategoritë përkatëse **[D82, D83]. (Kapitulli I Standardi I.6)**

3.7 IKT-ja ofron programe studimi në përputhje me legjislacionin shqiptar, aktet nënligjore në fuqi, Statutin dhe rregulloret e institucionit. Programet që ofrohen në ciklin e parë të studimit vazhdojnë edhe në ciklin e dytë të studimit, duke u dhënë mundësinë studentëve të thellojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre, dhe të përfitojnë nga mundësi specializimi sipas profilit të programeve **[RVB f. 59-60]**. Programet studimore të ciklit të parë u ofrojnë studentëve njohurinë bazë, metodat dhe parimet e përgjithshme shkencore, dhe formimin e aftësive në një gamë të gjerë profesioneve dhe specialitetesh. Këto programe përfundohen me 180 kredite (Sistemi Evropian i Transferimit dhe Akumulimit të Kriteve - ECTS) dhe zgjasin normalisht 3 vite akademike. Në fund të programit studimor të ciklit të parë, universiteti lëshon një diplomë "Bachelor" në përputhje me rregullat e specifikuar në Statut. Programet e studimit të ciklit të dytë ofrojnë njohuri të thelluara teorike dhe praktike, si edhe trajnime për kërkime të pavarura në një fushë brenda specialitetit përkatës. Këto programe përfundohen me 120 kredite, ku përfshihen kreditet për projektin kërkimor, tezën, dhe kohëzgjatja e tyre normale është 2 vite akademike. Në fund të programit studimor të ciklit të dytë, institucioni lëshon një diplomë universiteti "Master Shkencor". Kalimi nga njëri cikël në tjetrin kryhet kur studenti i ka përbushur të gjitha detyrimet e tij, pra, ka kaluar të gjitha lëndët/modulet, ka ndjekur praktikën mësimore dhe ka mbrojtur temën e diplomës. Kriteret për regjistrimin në programet studimore të ciklit të parë përcaktohen çdo vit me Vendim të Senatit Akademik. Rregulloret e Programeve Studimore publikohen dhe mund të gjenden në bibliotekën e institucionit **[D3, D84, D83, D108, D109]. (Kapitulli I Standardi I.7)**.

3.8 Përmes Zyrës së Pranimeve, institucioni ndjek procesin e regjistrimit të kandidatëve dhe të marrjes së informacionit për programet studimore. Kjo zyrë u ofron kandidatëve të gjithë informacionin e nevojshëm për t'u familiarizuar me institucionin, programet studimore, mënyrën e funksionimit, tarifat, bursat, stafin akademik, aktivitetet, klubet e studentëve, etj. Herë pas here, institucioni organizon Javën e Hapur dhe Ditët e Hapura, gjatë të cilave kandidatët për studentë mund të vizitojnë institucionin. Institucioni dhe njësitë bazike (departamentet), në bashkëpunim me zyrat e përmendura më lart, u ofrojnë studentëve tutorim akademik. Çdo staf akademik publikon orarin kur ai/ajo pret takime me studentët, dhe e bën atë publik duke e vendosur në derën e zyrës ose në programin mësimor që studentët kanë marrë gjatë javës së parë. Lista e studentëve, e cila shpërndahet nga Zyra e Këshillimit Akademik, publikohet gjithashtu në tabelën e njoftimeve të institucionit **[D61, D62, D63, D64, D8, D118, D97, D98; Turi]**. Institucioni ka përdorur prej vitesh platforma interaktive si "Google Classroom", "Google Drive" dhe "Google Meet" në proceset administrative dhe institucionale **[Aneksi nr.2, Tabela nr. 14]**. Institucioni përdor rregulloret dhe strategjitë e tij për të ndjekur dhe zhvilluar procesin e mësimdhënies, si dhe për të nxitur stafin akademik të përqafojë dhe të mbështesë koncepte të reja në lidhje me teknikat pedagogjike dhe metodat e mësimdhënies alternative **[D8]. (Kapitulli I Standardi I.8)**.

3.9 Institucioni ka dy njësi kryesore, dhe secila prej tyre ka dy njësi bazike dhe një Qendër Kërkimore të quajtur QIKZH (Qendra për Inovacion, Kërkim dhe Zhvillim) **[Aneksi nr. 1, Tabela 1-8]**. Stafit që ka grada dhe tituj shkencorë angazhohet plotësisht në kërkimet shkencore. Ata mbështesin dhe mbikëqyrin veçanërisht studentët e ciklit të dytë. Njësia për Inovacion, Kërkim dhe Zhvillim ndjek dhe zbaton politika dhe procedura të qarta për kërkimin shkencor, inovacionin dhe zhvillimin. Në fund të çdo viti akademik, njësitë publikojnë raporte për kërkimet shkencore, projektet dhe angazhimet e ndryshme në fakultet. Njësitë angazhohen në projekte, në organizimin e konferencave shkencore, në botimin e revistës shkencore të indeksuar, si dhe marrin pjesë në aktivitete të ndryshme që kanë për qëllim

forcimin e punës kërkimore [D99, D100, D102, D101, D9, D78, D79; M5, M10]. IKT-ja ka angazhuar staf ndërkombëtar, të cilët përbëjnë 26.5% të stafit dhe vijnë nga vende si: Kanadaja, Greqia, Turqia, Anglia, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Kosova, etj. 73% e stafit akademik kanë grada dhe tituj. 27% kanë Master Shkencor [RVB f. 64; M5; Aneksi nr. 1, Tabela nr. 1-8]. Studentët marrin pjesë në kërkime shkencore të organizuara nga stafi akademik, botojnë në revistën shkencore të indeksuar të institucionit, si dhe marrin pjesë në konferenca të ndryshme shkencore [Aneksi nr. 2, Tabela nr. 3, 7, 9]. Praktika profesionale dhe projektet për diplomën e studentëve zhvillohen në bashkëpunim me sektorin privat dhe kompanitë shtetërore [Aneksi nr. 1, Tabela nr. 9]. Institucioni mbledh të dhëna për punësimin e studentëve në fushën që kanë studiuar apo jashtë saj. Këto të dhëna përfshihen në raportet e përgatitura nga njësitë kryesore dhe ato bazike, apo komitete të tjera, për strukturat drejtuese. Këto raporte u dorëzohen strukturave drejtuese të IKT-së, të cilat më pas i analizojnë dhe nxjerrin përfundime, duke dhënë gjithashtu rekomandimet e nevojshme [D35, D9, D32]. (Kapitulli I Standardi I.9).

3.10 Institucioni bashkëpunon me institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Gjatë viteve të fundit, këto bashkëpunime janë intensifikuar dhe kanë ofruar mbështetje në disa fusha të rëndësishme, si për shembull: Bashkëpunimi me Erasmus+ për lëvizshmërinë e stafit dhe studentëve; bashkëpunimi me CEEPUS për lëvizshmërinë e stafit dhe studentëve; njohja e krediteve për programe të caktuara, etj. Një numër i konsiderueshëm stafi akademik dhe studentësh kanë përfituar nga kjo mundësi për lëvizje falë marrëveshjeve të firmosura nga institucioni me universitete të tjera të BE-së. Institucioni ka marrëveshje të ngjashme me 16 universitete në kuadër të programit Lëvizshmëria Erasmus+ [Aneksi nr. 1, Tabela nr. 9; Tabela nr. 20-24/2] [D33; M3, M4]. Për të lehtësuar lëvizjen e studentëve, institucioni ka miratuar Manualin për Lëvizshmërinë e Studentëve dhe Stafit [D104]. Fakulteti i Ekonomisë ka firmosur një marrëveshje për njohjen e krediteve të përbashkëta për ciklin "Bachelor" në programin Administrim Biznesi me Kolegjin Universitar Gjeorgjian në Ontario, Kanada. Negociatat vazhdojnë për njohjen e krediteve për programe të tjera studimi me të njëjtin institucion [D36]. Programet e ciklit të dytë pasojnë programet studimore të ciklit të parë, dhe përkojnë me nivelin e kualifikimit 6 dhe 7. Institucioni nuk ofron programe studimi të ciklit të tretë, duke qenë se ai ka statusin e Kolegjit Universitar. Veprimtaritë formuese të programeve të studimit përputhen me shpërndarjen e tyre sipas kategorive formuese A-E. Studimet janë organizuar në lëndë dhe module, dhe vlerësohen në kreditë sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Akumulimit të Krediteve (ECTS). Një vit akademik ka 60 kredite, të shpërndara në 30 kredite për çdo semestër. Praktika dhe mbrojtja e diplomës zhvillohen në semestrin e dytë të vitit të fundit për çdo cikël studimi. Leksionet ndahen në orë në auditor dhe orë jashtë auditorit. Pjesëmarrja në procesin mësimor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, projekte) është e detyrueshme në masën 75% (shtatëdhjetë e pesë). Diplomat e lëshuara në fund të programeve të ciklit të parë dhe të dytë shoqërohen nga suplementi i diplomës [Aneks nr. 1, Tabela nr. 14-40, D103, D84, D105]. (Kapitulli I Standardi I.10)

3.11 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm evidentoi se programi mësimor ka një raport të balancuar mes teorisë dhe praktikës. Raporti mes orëve të teorisë dhe praktikës: leksione / seminare + ushtrime është i balancuar 50% me 50% (duke mos përfshirë praktikën e mësimdhënies) [Aneksi nr. 1, Tabela nr. 14-40]. IKT-ja është e angazhuar në mbështetjen e programeve mësimore "të orientuara tek projektet". Kjo vihet re në programet e lëndëve, ku shumica e tyre përfshijnë një projekt që duhet të përgatitet nga studentët dhe të dorëzohet në fund të kursit. Programet e studimit projektohen duke u bazuar në programe të ngjashme që ofrohen nga universitetet ndërkombëtare, veçanërisht universitetet kanadeze. Përveç krediteve të ofruara sipas sistemit Evropian ECTS, programi ofron gjithashtu mundësinë për konvertimin

e krediteve sipas sistemit që përdoret në Amerikën e Veriut [D103, D105, D84]. Institucioni zbaton rregulla, manuale dhe procedura të posaçme për kërkimin e praktikës në mësimdhënie dhe mbrojtjes së diplomës [D8, D106, D84, D108, D109, D110]. Në fillim të çdo viti akademik, institucioni miraton Planin Kalendarik Vjetor, ku përcaktohen sezonet e diplomimit sipas periudhave përkatëse. Plani kalendarik miratohet me Vendim të Senatit, dhe publikohet çdo vit në faqen zyrtare të internetit për të dy ciklet e studimit [D84, D109, D103, D106, D97, D107]. Institucioni mbështet idetë novatore të studentëve dhe ka krijuar mundësitë financiare për t'i mbështetur studentët t'i zhvillojnë dhe realizojnë këto ide. Institucioni ka mbështetur financiarisht studentët për të zhvilluar platforma të teknologjisë së informacionit, ka ofruar bursa, si dhe ka ofruar çmime për studentët që kanë marrë pjesë në konkurse dhe kanë fituar [Aneksi nr. 2, Tabela nr. 3; 6-9; 17]. *(Kapitulli I Standardi I.11)*

- 3.12 Përmbajtja e veprimtarive formuese, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave të mësimdhënies i lejon studentët të thellojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për të vazhduar studime të mëtejshme apo për t'u punësuar në tregun e punës vendas apo ndërkombëtar. Organizimi i mësimit në gjuhën angleze, literatura e përdorur në mësimdhënie (në bashkëpunim me "McGrawHill Education", si dhe prania e stafit vendas dhe të huaj me përvojë akademike, shërbejnë si një garanci për studime cilësore që i përgatisin studentët për një karrierë akademike apo për tregun e punës. Në çdo program studimor, studentët kanë mundësi të familjarizohen me mundësitë e punësimit, si në formatin PDF ashtu edhe në prospektin e publikuar. Aftësitë, njohuria dhe kompetencat që fitohen gjatë procesit të të nxënit koordinohen mjaft mirë me praktikën profesionale, trajnimet, seminarët, workshop-et, etj., të cilat janë pjesë integrale e programeve të studimit [D42, D111, D112]. Njësitë kryesore marrin gjithashtu pjesë në panairët e punësimit dhe ftojnë kompani të ndryshme dhe ekspertë të fushës të shpjegojnë dhe të ndajnë përvojën e tyre në auditor me studentët mbi proceset e praktikës profesionale që ofrohen nga institucionet e tyre. Institucioni i informon studentët në mënyrë periodike për mundësitë e punësimit që vijnë në institucion nga kompani apo sipërmarrje të ndryshme [M3; M4]. Përmes strukturave të veçanta, institucioni ka ruajtur kontakt të vazhdueshëm me studentët e diplomuar (ALUMNIT), duke ndjekur kështu progresin, punësimin dhe zhvillimin e tyre. Njësia kryesore mbledh të dhëna të rëndësishme për punësimin e tyre, dhe organizon aktivitete të dedikuara për ALUMNIT. Institucioni vlerëson përvojën e tyre dhe ruan marrëdhënie të vazhdueshme me ta. Opinione të përzgjedhura nga ALUMNIT publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe zënë një vend të veçantë në vlerësimin e ALUMNIT për periudhën që kanë studiuar në IKT [D32, D90, D89]. *(Kapitulli I Standardi I.12)*

## **Gjetje**

### **Praktika e mirë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi si praktikë të mirë faktin që institucioni financon pajisjen e studentëve me libra dhe ofron abonime falas në biblioteka virtuale si “McGrawHill” dhe “O'Reilly”. **(Kapitulli I Standardi I.4)**

### **Pikat e dobëta**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

### **Rekomandime**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Rekomandohet që institucioni të bëjë përpjekje të mëtejshme për të formalizuar disa nga marrëveshjet e bëra me sipërmarrje të ndryshme duke marrë masa konkrete. **(Kapitulli I Standardi I.1)**

### **Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

### **Gjykimi**

Standardet për Programet e Studimit janë **përbushur plotësisht**.

#### **Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, të Mësuarit, Vlerësimi dhe Kërkimi**

- 4.1 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm evidentoi se institucioni merr të gjitha masat e nevojshme për fillimin dhe organizimin e vitit akademik, si dhe për përgatitjen dhe ruajtjen e të gjithë dokumentacionit të kërkuar. Nga ruajtja e dokumentacionit të dorëzuar dhe kontrolli i programeve studimore, rezultoi se institucioni e angazhon personelin akademik në bazë të programit studimor, kurseve të ofruara dhe profilit të kërkuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm evidentoi se niveli i stafit akademik është në përputhje me programet studimore ku ata janë angazhuar [D27, D48, D49, D111, D112]. Institucioni është i angazhuar në zbatimin e plotë të planeve dhe programeve të mësimdhënies, dhe të çdo lënde që ofron për çdo program studimi, duke bërë një shpërndarje të ngarkesës në mësimdhënie për orët në auditor (leksione, seminare, laboratorë, etj.) dhe orëve jashtë auditorit (orët e studimit individual). IKT-ja ofron infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve. Mjediset janë pajisur me logjistikën e nevojshme për organizimin e procesit mësimor, ku përfshihen: ngrohja-ftohja, ndriçimi, tabelat, projektorët, kompjuterët në laboratorë. Gjatë vizitës në mjediset e institucionit, rezultoi se laboratorët kompjuterikë janë të pajisur me programet e duhura për të garantuar që procesi mësimor të shkojë siç duhet. Programet e instaluara mund të përdoren falë kontratës që institucioni ka me Microsoft-in [D17]. Për të garantuar zhvillimin e vazhdueshëm të cilësisë së praktikave profesionale në institucion, është krijuar Zyra për Çështjet Studentore dhe Këshillimin e Karrierës, e cila ka për synim të përgatisë studentët për procesin e praktikave profesionale dhe të ofrojë informacionin dhe ndihmën e nevojshme [D8, D119, D120, D63, D64, M6, Turi]. Nga vizita në mjediset e institucionit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm evidentoi se IKT-ja u ofron studentëve të tij një bibliotekë mjaft të pasur me libra elektronikë dhe të shtypur, si dhe ka firmosur një marrëveshje me “Agjencinë e Abonimit të Shtypit” për ofrimin e periodikëve më të njohur ndërkombëtarë në fushën e ekonomisë dhe inxhinierisë [D42, D41, D121, D95; Turi]. *(Kapitulli I Standardi II.1)*
- 4.2 Institucioni përdor kritere dhe mënyra për të testuar dhe vlerësuar njohuritë dhe aftësitë e studentit bazuar në rregulla specifike, të cilat mund të aksesohen nga studentët në bibliotekën e institucionit. Të dhënat mbi mënyrën e vlerësimit publikohen në “Udhëzuesin e Studentit”, i cili u shpërndahet studentëve në fillim të çdo viti akademik. Procesi i vlerësimit kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka për qëllim të inkurajojë studentët të mësojnë gjatë gjithë vitit [D8, D97]. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, procedurave, dhe nga takimet me studentët dhe stafin akademik, rezultoi se elementët kryesorë të kontrollit të vazhdueshëm në institucion janë: provimet, projektet, niveli i aktivizimit në seminare dhe në punën në laborator, provimet afatmesme, detyrat e kursit, vlerësimet pyetje-përgjigje, etj. Rezultati i provimit i dërgohet çdo studentit në hapësirën personale në SMU (Sistemi i Menaxhimit të Universitetit) brenda 2 javësh nga kryerja e provimit. Metoda e përdorur për vlerësimin e njohurive të studentit është përcaktuar në programin mësimor të kursit nga stafi akademik, ku përcaktohet rëndësia e çdo komponenti dhe shpërndarja e pikëve [D8, D107, D108, D109, M3, M4, M5]. Institucioni ka krijuar procedura dhe rregulla për trajtimin e ankesave të studentëve mbi vlerësimin. Ato mund të gjenden në Rregulloren e Sekretariatit Mësimor dhe në “Udhëzuesin e Studentit” [D97, D143]. *(Kapitulli I Standardi II.2)*
- 4.3 Gjatë shqyrtimit të informacionit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re se studentëve u jepet mundësia të vlerësojnë programet e studimit dhe kurset përmes pyetësorëve të përgatitur nga Njësia për Sigurimin e Cilësisë (NjSC). Pyetësorët janë anonimë, dhe ato përdoren dy herë në vit, në fund të çdo semestri për të gjitha lëndët e programeve studimore dhe për të gjithë lektorët. Pyetësorët arkivohen nga NjSC-ja, e cila analizon rezultatet dhe përgatit një përmbledhje që u dërgohet rektorit dhe dekanëve. Institucioni përdor metoda të ndryshme



për vlerësimin e stafit akademik. Procesi i vlerësimit ndiqet nga NjSC-ja. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm evidentoi përdorimin e formave të ndryshme të vlerësimit, si: vetëvlerësimi që bën stafi akademik në fund të çdo viti akademik, i cili organizohet nga fakulteti dhe NjSC-ja; vlerësimi i studentëve përmes pyetësorëve elektronikë për secilin kurs dhe program studimi, i cili organizohet dhe ndiqet nga NjSC-ja; vlerësimi i stafit akademik nga strukturat drejtuese; vlerësim i performancës së strukturave drejtuese nga rektorati (Vlerësimi i Performancës); vlerësim i institucionit nga stafi akademik [D86, D91, D140, D86, D124, D125]. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm evidentoi se NjSC-ja grumbullon dokumentacionin e programeve dhe lëndëve që vlerësohen nga studentët për komponentë që lidhen me mësimdhënien; programin e lëndës, metodologjinë e përdorur gjatë mësimdhënies; korrektesën; etikën e profesorit; zhvillimin e mësimi sipas kurrikulës; përdorimin e literaturës; angazhimin e studentëve, etj. Vlerësimet kryhen “online” përmes “Google Forms” dhe analizohen nga NjSC-ja. Vlerësimi i të gjitha lëndëve mbledhet dhe analizohet nga NjSC-ja, gjë që ofron një panoramë të përgjithshme të vlerësimit të studentëve për programin e studimit. NjSC-ja publikon në faqen zyrtare të internetit përmbledhje të raporteve të ndryshëm [D87, D126, D86, D88, D89, D90, D91, D127, Turi]. (Kapitulli I Standardi II.3)

4.4 Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që ndihmojnë stafin drejtues akademik dhe pedagogjik të performojë në mënyrën më të mirë të mundshme. Nga takimi me drejtuesit e institucionit, rezultoi se rektori, dekanët dhe shefat e departamenteve kanë udhëzime të qarta dhe të përcaktuara mbi punën që duhet bërë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Nga takimi me përfaqësues të NjSC-së, u evidentua se kjo zyrë punon për të arritur objektivat që kanë për synim të përmirësojnë në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e mësimdhënies, procedurave dhe politikave [D8, M8]. Për të garantuar, monitoruar dhe përmirësuar cilësinë e programeve mësimore, institucioni e bazon punën e tij në procedura dhe rregulla të hartuara posaçërisht për këtë qëllim. IKT-ja e vlerëson rëndësinë e vazhdimësisë së programeve dhe ka për synim të përdorë burimet e disponueshme për të arritur rezultate maksimale. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm evidentoi se IKT-ja përdor burime të dhënash cilësore dhe sasiore për vlerësimin e lëndëve, programeve dhe procesit të mësimor, përfshi këtu vlerësimet nga studentët, stafi akademik, ALUMNIT dhe palët e interesuara [D8, D142]. Institucioni organizon aktivitete të ndryshme në formën e trajnimeve apo workshop-eve për të përmirësuar kualifikimet dhe trajnimin e stafit akademik [D64, D39, D141, Aneksi nr. 2, Tabela nr. 4. f. 7-8, M5]. (Kapitulli I Standardi II.4)

4.5 Secila nga njësitet kryesore ka një Njësi të Kërkimit Shkencor të quajtur “QIKZh Inxhinieria” dhe “QIKZh Ekonomia” (Qendra për Inovacion, Kërkim dhe Zhvillim). Njësia vepron në bazë të një rregulloreje të miratuar nga Senati Akademik, ku përcaktohen detyrat e kreut dhe stafit të njësies [D129, D130]. Institucioni ka krijuar grupe të kërkimit shkencor, të cilat miratohen në fillim të çdo viti nga Senati Akademik [D129, D130, D131, D27]. Fakultetet krijojnë punë grupi për nevojat e tyre, siç janë grupimet e lëndëve për qëllim orientimi [D118, D117]. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga takimi me organet qeverisëse, rezultoi se kërkimi shkencor kryhet si nga departamentet ashtu edhe nga Njësitet QIKZh të të dy fakulteteve, të cilët ndjekin një politikë që mbështet publikimet dhe kërkimin shkencor në disa plane. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm evidentoi se Njësitet QIKZh janë të përfshira në shumë çështje, si: publikimi i Revistës Shkencore të IKT, me numër ISSN dhe indeksim; organizimi i konferencave shkencore vendase dhe ndërkombëtare; publikimi i materialeve të konferencave shkencore në seksionin përkatës apo në gazetatat shkencore; publikim i raporteve të kërkimeve shkencore; publikim i Raportit Vjetor të Institucionit në faqen zyrtare të internetit, i cili gjithashtu përmbledh arritjet shkencore; publikimi i të gjitha aktiviteteve të institucionit në gazetën periodike të IKT-së; mbledhja, ruajtja dhe menaxhimi i kërkimit

shkencor në fakultet; përgatitja e formave të aplikimit për pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca ndërkombëtare apo publikime në revista shkencore, etj. **[D102, D101, D99, D100, D9, D115, D116, D78, D79]**. IKT-ja ka aplikuar dhe ka fituar disa projekte në bashkëpunim me institucione të tjera akademike dhe jo akademike **[D39; Aneksi nr. 2, Tabela nr. 10-13; 16-17]**. Njësia kryesore e çdo departamenti ka miratuar Planin Financiar për një periudhë 3-vjeçare, si dhe Planin e Mbështetjes Financiare për periudhën 2021-2025, ku mbështetja për kërkimet shkencore dhe publikimet ka një zë të veçantë **[D132, D133, D56, D57]**. *(Kapitulli II Standardi I.1)*

4.6 Stafit akademik i IKT-së përbëhet nga staf akademik relativisht i ri, ku 50% e stafit akademik me kohë të plotë zotëron një gradë Dr/PhD; 27% janë asistentë lektorë me diplomë Masteri Shkencor; ndërkohë që pjesa tjetër, 23% janë profesorë. Kjo është një bazë shumë e mirë për zhvillimin e kërkimit shkencor. Grupet e kërkimit shkencor organizojnë takime periodike dhe përcaktojnë objektivat afatshkurtra dhe afatgjata. Ata bashkëpunojnë dhe e koordinojnë aktivitetin e tyre Njësitë e Kërkimit Shkencor, si dhe me Zyrën për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Projektet **[D64, D9]**. Gjatë 5 viteve të fundit, institucioni ka punuar për 24 projekte në total, 5 prej të cilave i ka fituar, dhe për 3 prej tyre është ende në pritje të një vlerësimi **[Aneksi nr. 2, Tabela nr. 10-13, f. 14-15]**. Institucioni ka bërë progres duke investuar në krijimin e kushteve për të mbështetur idetë që vijnë nga grupet e kërkimit shkencor përmes krijimit të “Qendrës së IKT-së” (IKT HUB), e cila është një laborator teknik për zhvillimin e ideve të stafit dhe studentëve. Gjetjet shkencore të stafit akademik dhe studentëve publikohen në Revistën e Indeksuar të IKT-së. Kjo revistë shkencore i kushton një hapësirë të konsiderueshme publikimeve të kërkimeve shkencore nga studentët në bashkëpunim me stafin akademik **[Aneksi nr. 2, Tabela nr. 10-13, f. 14-15; Tabela nr. 25-26, f. 29-30; D102]**. Si praktikë të mirë mund të përmendim mbështetjen që stafi akademik në bashkëpunim me studentët ka dhënë për realizimin e projekteve të ndryshme publike dhe sociale në formën e kontributeve për ministritë, organizatat dhe bizneset e ndryshme **[Aneksi nr. 2, Tabela nr. 15, f. 16; D61, D62, D63, D64, D39]**. *(Kapitulli II Standardi I.2)*

4.7 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm thekson se institucioni ka firmosur marrëveshje të ndryshme me institucione partnere apo me biznese dhe sipërmarrje. Marrëveshjet mes tyre kanë objektiva të ndryshme në varësi të llojit të bashkëpunimit. Një numër i konsiderueshëm marrëveshjesh është firmosur për projekte të përbashkëta me universitete, institucione akademike brenda dhe jashtë vendit **[D35, D34, D33, D64; Aneksi nr. 2, Tabela nr. 10-13, f. 14-15; Aneksi nr. 1, Tabela nr. 9, f. 11-26]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm evidentoi se përveç projekteve ku ka aplikuar dhe ka fituar në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit, gjatë viteve të fundit institucioni ka organizuar një numër të konsiderueshëm konferencash ndërkombëtare, gjë që mbështet ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor **[D61, D62, D63, D64; Aneksi nr. 2, Tabela nr. 1-2, f. 2-3]**. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, u vu re se IKT-ja dhe njësitë kryesore kanë firmosur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare, ndër të cilat më të rëndësishmet janë ato me Shkollën e Biznesit në Harvard për ofrimin e kurseve të përbashkëta në Fakultetin e Ekonomisë; Kolegjin Gjeorgjian në Ontario, Kanada, për njohjen e krediteve të ciklit “Bachelor” për programin “Administrim Biznesi **[D37, D36, D42]**. Sipas të dhënave të shqyrtuara, stafi akademik i institucionit ka marrë çmime të ndryshme dhe certifikata vlerësimi për kontributet në fushën e kërkimit shkencor dhe në fusha të tjera të jetës akademike **[D134, D135, D144, D115, D116]**. *(Kapitulli II Standardi I.3)*

4.8 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe strategji shkencore në fushën e kërkimit shkencor. Gjithashtu, ai ka përcaktuar dhe zbatuar qëllimet dhe objektivat që lidhen me strategjitë dhe politikat e miratuara. Për të arritur këto objektiva,

IKT-ja ka angazhuar grupet e kërkimit shkencor, njësitë QIKZh, dhe struktura të tjera bashkëpunuese dhe organizative, të cilat ndjekin, koordinojnë dhe zbatojnë një strategji të qartë të kërkimit shkencor **[D1, D23, D8]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm evidentoi se IKT-ja ka përditësuar Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit deri në vitin 2025, dhe së bashku me të ka përcaktuar fushat prioritare të kërkimit shkencor mbi të cilat punon për arritjen e qëllimeve dhe objektivave **[D10]**. Në kontekstin e zhvillimit të kërkimit shkencor, institucioni ka miratuar Rregulloren “Për Kërkimin Shkencor”. Institucioni ka miratuar gjithashtu edhe “Politikat dhe Procedurat për Kërkimin, Zhvillimin dhe Kreativitetin”. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zbuloi se strategjitë dhe dokumentet e përmendura janë miratuar nga organet kolegjiale të institucionit, si nga Senati Akademik ashtu edhe nga Bordi i Administrimit. Për hartimin e tyre kanë punuar ekspertë nga bota e akademisë, kërkimit shkencor dhe sigurimit të cilësisë **[D23, D8]**. **(Kapitulli II Standardi I.4)**

4.9 Nga takimet që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm organizoi me përfaqësues të stafit u evidentua se në fillim të çdo viti akademi, IKT-ja miraton në organet kolegjiale objektivat e institucionit dhe të fakulteteve. Objektivat institucionale janë në një linjë me Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit, dhe gjithashtu përfshijnë objektiva të kërkimit shkencor. IKT-ja ka arritur të plotësojë objektivat e vendosura në fushën e kërkimit shkencor duke vepruar përmes njësiteve QIKZh, dhe përmes tyre ka krijuar projekte shkencore të përbashkëta me partnerë vendas dhe të huaj. Institucioni ka rekrutuar staf akademik me përvojë në fushën e kërkimit shkencor. Stafi ndërkombëtar në institucion përbën 26.5% të stafit akademik **[D136; Aneksi nr. 1, Tabela nr. 1-8, f. 3-10; M10]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm evidentoi se me qëllimin për të zgjeruar kapacitetet e tij kërkimore, IKT-ja e ka integruar kërkimin shkencor në politikat e tij si një komponent të ngarkesës mësimore të stafit. Për të nxitur Kërkimin, Zhvillimin dhe Kreativitetin, IKT-ja ofron një kurrikulë akademike të larmishme për stafin që punon me kohë të plotë. Duke marrë parasysh burimet njerëzore dhe teknike, institucioni ka përzgjedhur një numër të konsiderueshëm të stafit akademik, kryesisht kërkues me përvojë, por edhe të rinj, në mënyrë që të përfshihen në projektet kërkimore **[D61, D62, D63, D64; Aneksi nr. 1, Tabela nr. 1-8, f. 3-10]**. Për të realizuar aktivitetin shkencor, IKT-ja bashkëpunon jo vetëm me institucione akademike partnere, por edhe me sipërmarrjet, bizneset dhe industrinë **[D135, D115, D116, D99, D100, D137, D61, D62, D63, D64; Aneksi nr. 2, Tabela nr. 1-3; 25-26; 27]**. Çdo vit, institucioni raporton në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për plotësimin e objektivave vjetore, përfshi këtu objektivat shkencore **[D39, D9]**. **(Kapitulli II Standardi I.5)**

4.10 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka evidentuar se IKT-ja mbështet mjaftueshëm kërkimin shkencor, dhe se kjo mbështetje kryhet në mënyrë të vazhdueshme. Vazhdimësia në fushën e kërkimit shkencor vihet re edhe në firmosjen e marrëveshjeve afatgjata; në aplikimin për projekte dhe fitimin e tyre vetëm apo me partnerë; në publikimin e rezultateve të kërkimit shkencor në revista dhe në organizimin e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare; në angazhimin e stafit për t'u kualifikuar për marrjen e një grade shkencore dhe titulli akademik, si dhe në këmbimin e përvojave përmes projektit “Erasmus+ Lëvizshmëria” dhe partnerëve të tjerë **[D29, D33, D61, D62, D63, D64; Aneksi nr. 2, Tabela nr. 10-13; 16]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm doli në përfundimin se objektivat institucionalë përcaktohen në përputhje me objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit dhe objektivat e kërkimit shkencor. Në fund të çdo viti akademik, institucioni raporton për përmbushjen e këtyre objektivave në raportin që i dorëzon Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. IKT-ja raporton për objektivat që ka vendosur në fillim të vitit akademik dhe për plotësimin e tyre në fund të vitit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se veprimtaria e kërkimit shkencor të IKT-së është në përputhje me kapacitetet institucionale, qofshin ato infrastrukurore apo burime njerëzore **[D1, D136, D9, D64, Aneksi nr. 2, Tabela nr. 20-22/2; Aneksi nr. 1, Tabela nr. 9]**. IKT-ja e mbështet punën kërkimore të studentëve duke mundësuar pjesëmarrjen e tyre në aktivitete

si konferenca studentore, konkurse, projekte, etj. Në vitet e fundit, institucioni e ka shtuar angazhimin në fushën e projekteve, ku vlen të përmendet se ka angazhuar studentë, të cilëve u është dhënë mundësia të përfshihen në punë eksperimentale dhe të punojnë për temat e diplomave të tyre (8 studentë: 4 në Universitetin e Grazit në Austri, dhe 4 në Universitetin e Olomouc-it në Republikën Çeke [D29, D33, D63, D64; Aneksi nr. 2, Tabela nr. 20-24/2]. **(Kapitulli II Standardi I.6)**

4.11 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi se IKT-ja i shpërndan rezultatet e kërkimeve shkencore përmes publikimeve të ndryshme, organizmit të simpoziumeve, konferencave dhe tryezave të rumbullakëta, si edhe përmes aktiviteteve promovionale. Njësia QIKZh mbledh, analizon dhe publikon raporte periodike mbi kërkimin shkencor në institucion. Gjithashtu, institucioni boton Revistën Shkencore të IKT-së, publikon zhvillimet e konferencave shkencore, si dhe publikon Gazetën e IKT-së, e cila është një buletin informacioni mbi të gjitha aktivitetet e organizuara nga institucioni [D39, D138, D102, D9, D99, D100, D101]. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, u vu re se IKT-ja ka organizuar një numër të konsiderueshëm konferencash ku merr pjesë stafi akademik: 16 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, ndër të cilat, një pjesë është organizuar me bashkëpunimin e të dy fakulteteve, dhe pjesa tjetër me bashkëpunimin e institucioneve partnere brenda dhe jashtë vendit. Një numër i madh aktiviteteve është organizuar në formën e seminareve të hapura apo simpoziumeve shkencore me një pjesëmarrje të lartë ndërkombëtare. Të gjitha punimet e stafit akademik apo studentëve publikohen falas në "Revistën Shkencore të IKT-së" apo në seksionin për zhvillimet e konferencës [D136, D138, D101, D102; Aneksi nr. 2, Tabela nr. 1-3]. **(Kapitulli II Standardi I.7)**

4.12 Nga të dhënat e shqyrtuara, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re se IKT-ja ka si objektiv të kërkimit shkencor krijimin e lidhjeve mes rezultateve të kërkimit shkencor në fushat e programeve studimore në vend, në rajon dhe më tej. Institucioni e vlerëson progresin e studimeve dhe kërkimit shkencor të stafit akademik përmes raporteve vjetore nga Njësia QIKZh, bazuar në raportin e njësive bazike. Mbi bazën e tyre, Zyra e Rektorit në bashkëpunim me zyra të tjera si NjSC-ja, zyrat e zëvendës rektorëve, etj., hartojnë raportin vjetor në nivel institucioni. Në këtë raport, çdo pjesëtar i stafit akademik deklaron veprimtarinë e kërkimit shkencor si: publikime kombëtare apo ndërkombëtare, konferenca dhe projekte të fituara, etj. Përmes vendimeve të tij, Bordi i Administrimit ka mbështetur reduktimin e ngarkesës mësimore për stafin e angazhuar në studimet e doktoratës apo në projekte shkencore dhe kërkimore [D77, D140, D35, D9, D115, D116]. Aktivitetet e organizuara në bashkëpunim me institucionet brenda dhe jashtë vendit, dhe publikimet në revistat shkencore të njohura janë një mundësi për të njohur, vlerësuar dhe transferuar kërkimet shkencore të stafit akademik. Institucioni dokumenton aktivitetet kërkimore dhe publikimet në faqen zyrtare të internetit, publikon të gjitha materialet e konferencave, revistën shkencore dhe materiale të tjera me interes shkencor. Institucioni mbështet dhe inkurajon kërkimin shkencor të stafit akademik përmes pjesëmarrjes në projekte, dhe publikimit të rezultateve të tyre në konferenca dhe revista kombëtare dhe ndërkombëtare. Për të gjithë stafin e regjistruar në studime e doktoraturës, institucioni ndjek një politikë favorizuese, duke reduktuar ngarkesën mësimore dhe duke u lejuar atyre kohë të lirë për të punuar për artikuj dhe për të marrë pjesë në konferenca shkencore [D39, D138, D102, D9, D99, D100, D101]. **(Kapitulli II Standardi I.8)**

## **Gjetje**

### **Praktika e mirë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

### **Pikat e dobëta**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

### **Rekomandime**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

### **Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

## **Gjykimi**

Standardet për Mësimdhënien, të Nxënit, Vlerësimit dhe Kërkimit janë **përbushur plotësisht**.

## **Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre**

5.1 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re se IKT-ja zbaton politika të zhvillimit afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të institucionit, të cilat janë bazuar në misionin dhe vizionin e përcaktuar në Statutin e institucionit, ku përfshihet edhe rekrutimi i studentëve. Institucioni harton politika specifike për regjistrimin e studentëve duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara për këtë qëllim. Kufiri për pranimin e studentëve të rinj në programet e ciklit “Bachelor” ishte nota mesatare 6.5, dhe për programet e ciklit “Master” preferohej nota mesatare mbi 7.5. Gjatë takimit me përfaqësuesit e stafit, u theksua se institucioni ka për qëllim të tërheqë studentë me notë mesatare të lartë në mënyrë që të garantojë cilësinë e programeve të ofruara. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm evidentoi se institucioni i publikon kriteret e pranimit në faqen zyrtare të internetit, në kategorinë e posaçme “Pranimet”. Të dhëna të detajuara ofrohen gjithashtu edhe për dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin dhe bursat që institucioni ofron sipas kategorive përkatëse **[D10, D97, D148, D81, D54, D55, M10]**. Nga dokumentet e shqyrtuara dhe nga takimi me stafin administrativ dhe akademik, rezultoi se IKT-ja ofron shërbime të veçanta për studentët përmes Zyrës për Çështjet Studentore dhe Këshillimin e Karrierës. Këto zyra ofrojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët e ardhshëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re se institucioni është aktiv dhe se përdor broshura, materiale të ndryshme informuese, publikime, si dhe përditëson faqen zyrtare të internetit me të dhënat për studentët e pranuar për të informuar publikun dhe palët e interesuara për institucionin, programet studimore dhe mundësitë për bursa për studentët më të mirë **[D97, D148, D81, D54, D55, D63, D64, M5, M6]**. *(Kapitulli I Standardi III.1)*

